



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Opština Klokot-Vrbovac/Komuna e Kllokot-Vrbovcë

RREGULLORJA NR: 01/2015 MBI TRANSPARENCE

KLLOKOT-VËRBOVC
TETOR 2015

Në bazë të nenit 11,nenit 12,pika 12.2 (c), neni 68.4 dhe 68.5 Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040 Udhëzimeve Administrative nr. 05/2013 mbi transparencën nëpër komuna.Ligjit nr. 03/L-215, mbi qasjen e dokumentacionit publik si dhe neni 13.32.37.38.39.40.41.42 Statusit të Komunës Kllokot-Vërbovc aprovon:

RREGULLORËN MBI TRANSPARENCËN

Neni 1. Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim që të përforcoj transparencën e ekzekutivit legjislativ dhe administratës komunale gjatë kryerjes detyrave dhe përgjegjësive të tyre,si dhe për të rritur pjesëmarrjen publike në vendim marrje në nivelin lokal qeveritar dhe për të lehtesuar qasjen publike dhe pasqyrën në dokumentat zyrtare komunale.

Neni 2. Fushëveprimi

Me këtë rregullore komunale rregullohet pjesëmarrja publike në seancat e Kuvendit komunal dhe të komisioneve të tij,takimet publike,obligimi për njoftimin publik,konsultimet me publikun para miratimit të rregulloreve komunale,pjesëmarrja publike në marrjen e vendimeve,si dhe qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 3. Kushtet e përgjithshëm

Kushtet e nevojshme për këtë Rregullore kanë këto domethënje:

- „**Seancat e Kuvendit Komunal**,,- janë seanca të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit komunal;
- „**Komisionet**,,-janë organe ndihmëse të Kuvendit komunal;
- „**Pjesëmarrja Publike**,,- nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve tjera të interesuar në proceduart e marrjes së vendimeve në nivelin lokal;
- „**Njoftimet publike**,,- nënkupton njoftimin e qytetarëve mbi punën e organeve komunale rrugën e njoftimit publik në vendet më të frekuentuara mbrenda teritorit të komunës,tabela e shpalljeve në objektin e Komunës,forma e shkruar dhe elektronike në medijat lokale,ëb-faqet zyrtare dhe në mënyra të ndryshme.
- **Diskutimet e hapura**,,- nënkupton takimet e rregullta me qytetarët dhe me grupet tjera të interesuara të cilat i organizon komuna dhe organet e tij me qëllim që ti njoftoj qytetarët me punën e organeve komunale dhe pyetjeve të ndryshme të parashtruara nga ana e qytetarëve;
- „**Peticionet**,,-nënkupton kërkesën e qytetarëve dërguar Kuvendit komunal në formë të shkruar,dhe vlenë për cdo pyetje që është mbrenda kompetencave komunale;
- „**Konsultimet e hapura mbi aktet komunale**,,- nënkupton organizimet e takimeve nga organet komunale me qytetarët gjatë së cilës marrin propozimet e qytetarëve para aprovimit të akteve komunale,

- „Qasjen në dokumentat zyrtare,,- nënkupton të drejtën e qytetarëve dhe grupeve tjera të interesuar që të kenë qasje të lirë në dokumentat zyrtare të komunës.
- „Planin e zbatimit të transparencës në komunë,,- nënkupton planin e kryetarit të komunës për zbatimin në praktik të Rregullorës mbi transparencë.

Neni 4. Seancat e Kuvendit Komunal

4.1. Secila seancë e Kuvendit Komunal është e hapur,përfaqësuesit e mediave informative dhe subjekteve tjera të interesuar.

4.2. Kryesuesi i Kuvendit komunal përmes Zyrës për informim bën njoftim publik mbi mbajtjen e seancave të Kuvendit komunal dhe atë më së pagu shtatë (7) ditë para mbajtjes së seancave të rregullta të Kuvendit Komunal ose tre (3) ditë para mbajtjes së seancavë të jashtëzakonshme të Kuvendit komunal.

4.3. Lajmërimet publike mbi seancat e Kuvendit komunal bëhen përmes:

- Përmes lamërimeve publike në vendet më të frekuentuara mbrenda teritorit të komunës,
- Tabelave të shpalljes përrpara ndërtesës dhe Komunës;
- Web –faqes zyrtare të Komunës;
- Përmes medijave në formë të shkruar dhe elektornike dhe
- Në mënyra të tjera.

4.4. Lajmërimi i publik duhet të përmbajë:

- Datëm e mbajtjes së seancës;
- Kohën e mbajtjes së seancës;
- Vendin e mbajtjes së seancës;
- Rendin e ditës dhe
- Materijalin për seancë.

4.5. Kryesuesi i Kuvendit duhet të njoftoj Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së seancave të rregullta ndërsa Tri(3) ditë pune para mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal .

4.6. Seancat e Kuvendit komunal mund të janë pjesërisht ose plotësisht të mbyllura për publikun për arsy që janë të parapara me ligj.Në këto raste,me një vendim të caktuar,Kuvendi komunal apo komisionet e tij njoftojnë se takimet janë pjesërisht ose plotësisht të mbyllura për publikun.

Neni 5. Publikimi i dokumentave komunale

Të gjitha udhëzimet,rregulloret dhe aktet tjera të Kuvendit komunal publikimi i të cilave nuk është i kufizuar (ndaluar) me ligj për qasjen e dokumentave zyrtare,publikohen cdo javë pas mbajtjes së seancave gjatë të cilit ky akt është kryer përmes njoftimit publik në vendet më të

frekuentuara mbrenda tëritorit të komunës,tabelës së shpalljeve në ndërtesë e Komunës,në ëeb-faqen zyrtare të Komunës dhe në media në formë të shkruar dhe elektronike në Komunë.

Neni 6. Seancat e Komisioneve të Kuvendit

6.1. Seancat e komisioneve të Kuvendit komunal janë të hapura për publikun,përfraqsuesit e mediave informative dhe grupeve tjera të interesuara.

6.2. Kryesuesi i komisioneve të kuvendit përmes Zyrës për informim bën njoftim publik tri (3) ditë para mbajtjes së seancës.Lajmërimi publik përmban datën e mbajtjes së seancës,kohën e mbajtjes së seancës,vendin dhe rednin e ditës së seancës.

6.3. Të gjitha vendimet e komisioneve të kuvendit,publikimi i të cilave nuk është i kufizuar me ligjin ekzistues për qasjen në dokumentat zyrtare,duhet të jenë në dispozicion publik sipas kërkesës së tyre.

6.4. Komisionet e kuvendit mund të organizojnë konsultime publike me qytetarët dhe grupet e tjera të interesuara për pyetjet të cilat janë në kompetencë të komisioneve përkatëse të kuvendit.

Neni 7. Diskutimet e hapura

7.1. Komuna është e obliguar së paku 2 herë në vit të organizoj diskutime të hapura (mbledhje të hapura) me qytetarët ose me organizatata e interesuara për komunën mbi pyetjet të cilat ju interesojnë qytetarëve të Komunës Kllokot-Vërbovcë, e cila është në kompetencë të komunës.

7.2. Përvec dy mbledhjeve të obliguara publike,Kuvendi komunal duhet të hulumtoj mundësinë e organizimit periodik të mbledhjeve publike me qëllim të pjesmarrjes së drejtë për drejtë të qytetarëve në prurjen e vendimeve lidhur me buxhetin komunal,planifikimit hapsinorLokal zhvillimit të ekonomisë,shfrytëzimin e pronës komunale,planifikimin për investimet kapitale të hyrat që komuna i krijon dhe nevojave tjera për interesin e përgjithshëm.

7.3. Njëra prej mbledhjeve publike duhet të mbahet në gjysmën e parë të vitit,ndërsa mbledhja e dytë publike e obliguar duhet të mbahet në pjesën e dytë të vitit.

7.4. Kuvendi komunal shpall lajmërimin publik mbi datën,kohën,vendin dhe temat e diskutimit publik së paku dy (2) javë përpëra dhe në mënyrën e paraparë sipas nenit 4.3 të kësaj rregullore.

7.5. Në diskutimet publike mund të prezantojnë edhe përfraqsuesit e mjeteve të informimit publik.

7.6. Diskutimet publike organizohen në fshatra,në vendbanime dhe në pjesën e qyteteve.

7.7. Komuna me shpenzimet e veta siguron lokalit në kuadër të komunës së vet e cila i mundëson publikimit të gjërë prezencën në diskutimin publik.

7.8. Prezenca e udhëheqsve më të lartë të Komunës sikurse:Kryetari,Nënkyetari,Drejtorët e sektorëve për drejtorinë e përgjithshme,Shefi i shërbimit Kadastral (personelit),Drejtorët e sektorve tjerë komunal,Kryetari i komisionit të kuvendit (komisioni për Politikë dhe Financa dhe Komisioni për Komunitete) dhe zyrtarët tjerë të cilët janë kompetent për pyetjet të cilat përfaqësojnë temën e diskutimit publik janë të obliguar të prezentojnë në dikutim të hapur.

7.9. Prezentuesit e diskutimit publik mund ti shprehin mendimet e tyre, të japim sygjerime të caktuara dhe propozime për zgjidhjen e pyetjeve të caktuara të cilat janë në interes të tyre.

7.10. Kërkesat dhe porositë e qytetarëve si edhe grupeve të interesit të cilët prezantojnë në diskutimet publike evidentohen nga ana e Drejtoreve të sektorve komunal për Drejtorinë e përgjithshme ose Shefit të shërbimit kadastral dhe të njejtat kuvendi është i obliguar ti shqyrtoj në afat prej 15 ditësh prej kryerjes së diskutimit publik.

Neni 8. Petitionet

8.1. Seili person fizik ose juridik ka të drejtë që në iniciativën personale ,në formë të petitionit i propozon kuvendit komunal që të ndërmë masa të caktuara dhe të bie akte juridike nëpërmes së cilës do të zgjidhen problemet ose pyetjet të cilat janë të rëndësishme dhe të cilat janë në interes për qytetarët e komunës Kllokot-Vërbovcë.

8.2. Të gjithë personat fizik dhe juridik të interesuar mund ti paraqesin petition Kuvendit komunal për çfarðo pyetje e cila është në kompetencën e saj,sikurse janë pyetjet e rregullimit të qytetit,fshatit,ruajtjes së rendit dhe infrastrukturës komunale,mbrojtja hapësirës shtazore,hargjimi i mjeteve komunale,përcjellja e vet kontrollës,zhvillimi ekonomik lokal ,turizmi dhe të gjitha pyetjet të cilat janë në interes të qytetarëve të komunës Kllokot-Vërbovc.

8.3. Petitionin e bëjnë të gjithë personat fizik dhe juridik të interesuar e cila duhet të nënksahuhet kërkesa në të cilën nga Kuvendi komunal kërkojnë zgjidhjen e pyetjeve të caktuara dhe i dërgojnë petition Kuvendit komunal nëpërmes drejtorit të sektorit për Administratën e përgjithshme..Afati pwr shqyrtimin e petitionit tw dorzuar nga ana e personit fizik ose juridik nw Kuvend është 60 ditë sikurse është e përcaktuar me nenin 70. Ligjet nr:03-L040 të Qeverisjes Lokale

8.4. Secili petition duhet të përmbajë emrin dhe adresën e kërkuesve,d.m.th nënshkruar të petitionit dhe lëndës së petitionit.Lënda e petitionit duhet të jetë e kuartë dhe e definuar në secilën faqe të petitionit.Petitioni i cili nuk përbën elementet bazë nuk do të mirret në shqyrtim.

8.5. Drejtori i sektorit për drejtorinë e përgjithshme (administrative) në afat prej 30 ditësh nga pranimi i petitionit ,petitionin ia dërgon komisionit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit komunal në shqyrtim.Parashtruesit dhe nënshkruarët e petitionit mund të prezantojnë në mledhjet e komisinit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin komunal gjatë shqyrtimit të lëndës së petitionit.

8.6. Vendimin e fundit mbi lëndën e peticionit e bjen Kuvendi komunal në afat prej 6 javësh nga dita e dërgimit të peticionit në Kuvendin komunal.

8.7. Pas diskutimit në Kuvendin komunal Kryetari ose zyrtari komunal të cilin e cakton Kryetari,në afat prej më shumë se 15 ditësh nga data e shqyrimit të peticionit lajmëron parashtruesin e peticionit mbi vendimin.Vendimi i Kuvendit komunal në shiqim të peticionit duhet të arsyetohet në formë të shkruar parashtruesit të peticionit.

8.8. Në rastet kur peticioni ka kuptimin të cilat kryesisht komuna nuk është kompetent,Kryetari i komunës ose zyrtari të cilin e autorizon kryetari,në afatin i cili është paraparë sipas nenit 8.7 të kësaj rregullore,lajmëron në formë të shkruar parashtruesin e peticionit se nuk është kompetënt dhe të njejtën e përcjellë te organet kompetente,duke njofuar për këtë edhe parashtruesin e peticionit.

Neni 9. Konsultimet publike mbi aktet komunale

9.1. Të gjitha aktet komunale duke i përfshirë rregulloret,udhëzimet,propozimet e buxhetit dhe aktet tjera të rëndësishme komunale duhet të jenë lëndë për konsultime publike para aprovimit të kuvendit komunal.

9.2. Organet propozuese përgadisin tekstin e akteve komunale dhe përcaktojnë mënyrën në të cilën do të lajmërohen konsultimet publike,koha e konsultimit,duke përfshirë edhe konsultimet e obliguara me grupet e interesuara,diskutimet e hapura dhe mënyrat tjera të prezencës publike.

9.3. Zyra informim lajmeron publikun mbi konsultimet publike për akete komunale dy javë përpara dhe mënyrën e paraparë sipas nenit 4.3 të kësaj rrëgullore.

9.4. Lajmërimin e publikut mbi konsultimet publike dhe akteve komunale duhet të përmbajnë elementet e parapara në nenin 4.4 të kësaj rregullore.

9.5. Organet të cilat propozojnë aktin komunal prezentojnë në konsultime,arsyetojnë aktin,publikut i spjegojnë përmbajtjen e aktit dhe evidentojnë propozimet e dhëna nga ana publike gjatë konsultimit.Propozimet publike shqyrtohen në afat prej 15 ditësh prej momentit të kryerjes së konsultimeve.

9.6. Organi i cili propozon aktin informon Kuvendin mbi propozimet e dhëna,të papranuara dhe pranuara me sygjerime gjatë konsultimeve.Gjatë aprovimit të aktit komunal Kuvendi jep llogari që propozimet e argumetuara dhe të arsyeshme dhe sygjerimet nga konsultimet publike ti qes në tekstin e aktit të kryer.

Neni 10.
Gjuhët komunikimin zyrtar

10.1 Përfaqsuesit e Komuniteteve pakicë në komunën Kllokot-Vërbovc kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre në të gjitha organet komunale dhe me të gjithë zyrtarët komunal.

10.2 Këshilltarët e Kuvendit komunal dhe anëtarët e komisioneve të Kuvendit kanë të drejtë që në gjuhën e tyre të prezantojnë në diskutimin e rrjedhjes së mbledhjes.

10.3. Diskutimet dhe konsultimet publike udhëhiqen në dy gjuhë zyrtare, serbisht dhe shqip.

10.4. Aktet normative të Kuvendit komunal Kllokot-Vërbovc shtypen në gjuhën serbe dhe shqipe.

10.5. Të gjitha dokumentata zyrtzre të cilat i lëshon drejtoria komunale duhet të jenë në gjuhën me të cilën shërbehet pala. Me gjuhën e palës konsiderohet gjuha me të cilën pala në fillim i drejtohet drejtorisë komunale.

10.6. Detalet rreth përdorimit të gjuhës mund të rregullohen me akt të vecantë mbi përdormin e gjuhës.

Neni 11.
E drejta publike në qasjen e dokumentave zyrtare

11.1. Në harmoni me ligjin mbi prezantimin e dokumentave zytare dhe shpalljen e rregullores 04/2012 Ligji mbi Vetqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, Komuna Kllokot-Vërbovc garanton të gjithë personave fizik dhe juridik të drejtën në qasjen e dokumentave zyrtare komunale.

11.2. E drejta e qasjes në dokumentat zyrtare ka të bëjë në të gjitha dokumentat të cilat bihen ose aprovoohen nga organi komunal, përvèc nëse me ligj nuk është e paraparë ndryshe.

Neni 12.
Kërkesa për qasje në dokumenta zyrtare

12.1. Kërkesën për qasjen në dokumenta zyrtare parashtrohet në formë të shkruar. Kërkesa duhet të përbajë përshkrimin e informatës të cilat kërkoen në mënyrë që komuna të jetë në mundësi të njoftohen për cilin dokument është fjala.

12.2. Parashtruesi i kërkesës për qasjen në dokumentat zyrtare nuk ka nevojë të arsyetoj shkakun për kërkesën e parashtruar.

12.3. Në qoftëse Organi Komunal nuk e posedon dokumentin e kërkuar nga ana e parashtruesit të kërkesës, atëherë organi komunal obligohet në afat prej Pesë(5) ditë pune nga data e pranimit të kërkesës në formë të shkruar të përcjellë dokumentin organit kompetent që posedon informacion

12.4. Organi Komunal Obligohet që në afat prej 7 ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës të merr vendim për qasje në dokumentin e kërkuar ose të jep përgjegje në formë të shkruarë për ta arsyetur në tërsi ose pjesërisht refuzimin të cilin aji e ka parashtruesi i kërkesës për shqyrtim .

12.5. Afati për realizimin e të drejtës në qasje zyrtare mund të vazhdohet për 15 ditë nëse dokumenti kërkohet jasht organit komunal dhe në qoftëse në kërkesë janë disa dokumente publike

12.6.Organi kometent komunal është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit në formë të shkruar ti përgjigjet parashtruesit të kërkesës . Në qoftëse kërkesa është refuzuar , parashtruesi ka të drejtë ankese .ankesa i drejtorhet komisionit Komunal për ankesa e cila duhet të miratoj ose të refuzoj ankesën në afat prej 15 ditësh.

12.7Në qoftëse Organet Komunale nuk përgjigjen në kërkes për qasje në dokumente zyrtare në afat ligjor , parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të bëjë kërkesë për vërtetimin e pranimit të kërkesës . Në qoftëse kërkesa refuzohetë , organi komunal e njofton parashtruesin e kërkesës të filloj procedurën gjygsore ose ti praqitet Avokatit të Poipullit (Obduspersionit)

12.8 Zyra për informim , harton formularin për qasje në dokumenta zyrtare dhe ndihmon të interesurit fizik apo juridik me rastin e plotësimit të tijë .

12.9.Zyra për informim , nën udhëheqjen e drejtorit të Administratës së përgjithshme , i cili e mban regjistrin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.

Neni 13. Plani i transparencës.

13.1 Në harmoni me rregullorën mbi transparencën dhe nenin 9.të Udhëzimit Administrativ nr.05/2013 Ministria për Vetqeverisje Lokale,Kryetari aprovon planin e veprimit për transparencën në komunë.

13.2.Plan i transparencës në komunë përmban punët konkrete të cilat ofrojnë që në praktikë të zbatohen të gjitha obligimet në shiqim të transparencës të cilat janë të parapara me këtë rregullore dhe me ligjet në fuqi.Panet mbi transparencë në komuna kanë për qëllim mti ofrojn qytetarëve qasje në monitorim dhe zbatimin e akteve komunale , duke përfshirë edhe menajimin e financave publike përgjithsítë , prokurimin dhe sverat e tjera të cilat janë në interes të qytetarëve .

13.3. Plan i mundf të përfshijë : informimin më të shpeshtë në medija për qështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e buxhetit komunal , zhvillimit ekonomik , shfrytëzimi i pronës komunale , planifikimi urban , investimet , të hyrat komunale si dhe qështjet tjera të interesit të përgjithshëm . Mbajtja e konferencave periodike me gazetarë dhen përfaqësues të mjeteve lokale të informimit. Organizimin e debateve publike për të gjitha qështjet nga interesit publik.

13.4. Secila komunë duhet të mirmbaj ëeb-faqen sipas rregullores nr.03/2011 për ëep-faqet e institucioneve publike . Krijimi i ëeb-faqes zyrtare komunale ose rifreskimi ku do të publikohen planet urbane , raportet e punës të organeve punuese bëhet përmes Udhëzimit Administrativ nr:03/2011 për ëeb-faqen e institucioneve publike.

13.5 Plani për transparencë miratohet 30 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të rregullores për transparencë .

**Neni 14.
Rregulloret kaluese dhe të kryera**

Në të gjitha rastet ku kjo rregullore nuk është në harmoni me ligjin mbi vetqeverisjen lokale,ligjin mbi qasjen në dokumentat zyrtare dhe dispozitat e Kushtetutës së Kosovës zbatohen sipas rregullorës së ligjit dhe Kushtetutës.

Neni 15.

Hypja ne fuqi

Kjo rregullore hyn ne fuqi pas aprovimit në Kuvendin komunal,nënshkrimit të njëjtës nga ana e Kryesuesit të Kuvendit komunal dhe vlerësimit ligjor të rregullorës nga kompetenca e Ministrisë për Vetqeverisjen Lokale.

KUVENDI KOMUNAL KLLOKOT VËRBOVC

Numër :01/2015 data : 30.10.2015

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Zarko Dejanovic